

## **FTESË PËR OFERTË për:**

### **“Blerje Produkte Cisco“**

I/ E Nderuar Zoteri / Zonje

Union Bank Sha fton të gjitha Kompanite e interesuara në procedurën e Tenderimit për “Blerje Produkte Cisco”.

Qëllimi i kësaj Ftese për Ofertë është pranimi; vlerësimi dhe përzgjedhja e Propozimit/Propozimeve më të mirë që përmbush kërkesat e Bankës, sipas listes se produkteve të kerkuara.

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese:

- Vlerësimi mbi parametrat e produkteve te ofertuara dhe afati i levrimit i propozuar.
- Vlerësimi mbi bazën e cmimit më të mirë dhe final të ofruar nga kompania për produktet e kërkuara.

Faleminderit paraprakisht për pjesëmarrjen tuaj në këtë proces

Me respekt

Njesia e Prokurimit

Tiranë më, 17 Mars 2026

## 1. Hyrje

Union Bank (me poshte quajtur “Banka ose “UB”) është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 Janar 2006. Për më shumë informacion në lidhje me aktivitetin, madhësinë dhe gjendjen financiare të Bankës, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: [www.unionbank.al](http://www.unionbank.al)

## 2. Objekti i Fteses per Oferte

Union Bank fton kompani vendase të kualifikuara për të paraqitur një propozim për: “Blerje Produkte Cisco”.

Objektivi i kësaj Ftese per Oferte është të kërkojë oferta nga kompanitë e kualifikuara për përmbushjen e kërkesave sipas specifikimeve teknike te njejta apo te ngjashme te listuara ne Seksionin Nr 3 te Fteses per Oferte.

Si rezultat i kësaj kërkesë, do të lidhet një kontratë me çmim fiks për njësi sipas produkteve për furnizuesin/t i/e zgjedhur.

**Shënim: Ofertimi i pjesshem per blerjen te vetem nje pjese te Produkteve te kerkuara eshte i lejuar dhe oferta te tilla do te merren ne konsiderate per vleresim.**

!Nënkontraktimi nuk do të lejohet gjatë realizimit të kontratës, përveç rasteve kur miratohet paraprakisht nga Banka. Në rast se verifikohet, do të çojë në ndërprerje të menjëhershme të Kontratës.

Për të siguruar të njëjtin nivel informacioni për të gjithë pjesëmarrësit, çfarëdo përgjigje apo sqarimi shtesë që Banka do t'i japë një prej kompanive të interesuara, do të ndahet me pjesën tjetër të pjesëmarrësve në këtë proces.

Dokumentacioni Teknik dhe Financiar i kërkuar duhet të dorëzohet me zarf të mbyllur brenda datës **30 Mars 2026**, në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Administrates

Union Bank SHA

Bulevardi Zogu I, Sheshi Ferenc Nopça, Nd. 5, H. 3, Njësia Bashkiake Nr. 9, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri

me referencë **“Blerje Produkte Cisco”**

Ose ne version Elektronik me email në adresen [procurement@unionbank.al](mailto:procurement@unionbank.al)

Formati i propozimit duhet të përmbajë listën e dokumentacionit të përfshirë në Aneksin 1.

## 3. Pershkrimi Produkteve te kerkuara

Banka synon që të perzgjedhe kompani që mund të ofrojne produktet e kerkuara sipas specifikimeve teknike te listuara ne tabelen me poshte.

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Cisco C8200L-1N-4T (SD-WAN License) (SD 36 Months) DNA Essentials	cope	4
2	Cisco C9200L-24P-4G (SD 36 Months) DNA Essentials	cope	4
3	C8300-1N1S-4T2X Router (SD 36 Months) DNA Advantage	cope	2
4	Cisco C8200-1N-4T Router (SD 36 Months) DNA Advantage	cope	2
5	Cisco C1121X-8PLTEP (SD-WAN License) (SD 36 Months)	cope	5
6	Cisco 1000BASE-SX SFP transceiver module, MMF, 850nm, DOM.	cope	16
7	Fiber optike Multimode (OM2/OM3/OM4) me konektorë LC (5M)	cope	20

**Shenim:** Produktet e kerkuara duhet te ofrohen te reja dhe jo refurbished.

**Shenim:** Per produktet Cisco C8200L-1N-4T (SD-WAN License) (SD 36 Months) DNA Essentials dhe Cisco C9200L-24P-4G (SD 36 Months) DNA Essentials, kerkohet nga 1 cope prej seciles te kene afat levrimi te menjehershem ose me kohe levrimi brenda 2 javeve nga konfirmimi i Bankes. Ne Oferte jeni te lutur te specifikoni datat e levrimet per keto dy produkte.

#### 4. Skeduli i Procesit të Tenderimit

Data	Koment
17 Mars 2026	Publikimi i Fteses per Oferte
24 Mars 2026	Afati per dergimin e pyetjeve nga Kompanite
25 Mars 2026	Afati per kthimin e pergjigjeve nga Banka
30 Mars 2026	Afati per dorezimin e Propozimeve
22 Prill 2026	Njoftimi nga Banka mbi rezultatet e vleresimit
30 Prill 2026	Pregatitja e Kontrates dhe nenshkrimi me Fituesin/t

Bashkëlidhur Ftesës për Ofertë do të gjeni:

- Aneks 1. Kerkesat per dokumentacionin Teknik dhe Financiar
- Aneks 2. Specifikimet teknike te produkteve te kerkuara.

## **Shtojca 1      Kerkesat per dokumentacionin Teknik dhe Financiar**

### **Propozimi Teknik:**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentat e mëposhtëme:

1. Kopje të ekstraktit të QKB (të 6 muajve të fundit)
2. Dokument që verteton që Kompania është shites i autorizuar për produktet e kerkuara.
3. Letër Reference nga klientet kryesore për furnizim produktesh të ngjashme.
4. Çdo dokument tjetër shtesë që mund të shërbejë kësaj Ftese për Ofertë.
5. Bashkangjitur Fteses për Oferte do të gjeni edhe draft Kontraten që Banka propozon të lidhet me Fituesin / Fituesit. Bashke me propozimin Teknik dhe Financiar, do të mundësoni edhe përgjigjen tuaj (opinione / sugjerime / komente / konfirmim) mbi draftin e propozuar nga Banka

Të gjithë dokumentat sipërpërmendura duhet të jenë të aksesueshëm dhe të lexueshëm në momentin e dërgimit të tyre. Mos-dorëzimi i një dokumenti ose të dokumentave të pasakta, do të sjellë penalitet në vlerësimin që do realizohet ose do të konsiderohen si kushte për skualifikim nga ky proces.

### **Kriteret për kualifikimin e Kompanive pjesëmarrje në proces:**

- Eksperiencë në tregun vendas për furnizim të produkteve të kerkuara (minimumi 3 vjet),
- Eksperienca të ngjashme të mëparshme me banka të tjera dhe/ose korporata të mëdha.

### **Propozimi Financiar**

Në Ftesen për Oferte do të gjeni listën e produkteve dhe specifikimeve teknike të kerkuara mbi të cilat ju do të jepni propozimin tuaj Financiar.

Në Oferten Financiare duhet specifikuar nëse cmimet përfshijnë apo jo TVSH-ne.

Oferta Financiare duhet të përfshijë gjithashtu:

- ✓ Periudhen e Garancise të propozuar,
- ✓ Afati i levrimit të secilit produkt \_\_\_\_ dite kalendarike nga data e lidhjes së kontratës
- ✓ Kushtet e pageses që ju propozoni.
- ✓ Specifikimet teknike (data sheet) të seciles prej Produkteve të Ofertuara